

Po punoni në MB nga jashtë vendit?

Shëndeti dhe siguria juaj në punë

Albanian



This is an **Albanian** language version of pocket card INDG410

Hyrja

- Ligjet e MB-së për shëndetin dhe sigurinë ju mbrojnë si kur punoni këtu në mënyrë të ligjshme ashtu dhe të pa ligjshme.
- Punëdhënësi juaj duhet të mbrojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien tuaj.
- Ju keni të drejtën të dini se kush ju punëson. Nëse nuk e dini, pyesni.
- Ka disa gjëra që ju duhet t'i bëni në ndjekje të ligjit të MB-së për shëndetin dhe sigurinë.

Çfarë duhet të bëjë punëdhënësi juaj

Të përgjithshme

- Duhet t'ju informojë për çdo rrezik ndaj shëndetit dhe sigurisë që ka lidhje me punën tuaj.
- Duhet të afishojë një certifikatë që tregon se ka Sigurim të Detyrueshëm të Përgjegjësisë së Punëdhënësit.

Informacion dhe trajnim

- T'ju japë informacionin, udhëzimet dhe trajnimin që ju nevojitet për të punuar pa rrezik dhe të sigurohet se ju i keni kuptuar.
- Duhet të sigurohet se ju i kuptoni të gjitha shenjat e sigurisë në vendin tuaj të punës.
- Duhet të sigurohet që ju gjithnjë të mund të flisni me një mbikëqyrës me përvojë dhe që ju të mund ta kuptoni njëri-tjetrin.

Pajisjet dhe veshjet

- Duhet të mos ju lejojë të ngisni ose të drejtoni makineri, përfshi një traktor, përveçse kur jeni trajnuar siç duhet.
- Duhet të sigurohet që të gjitha pajisjet që ju duhet të përdorni të jenë të përshtatshme dhe të kontrolluara siç duhet.
- Nëse nevojitet, duhet t'ju japë (falas) pajisje mbrojtëse ose veshje, të cilat duhet t'ju mbajnë ngrohtë dhe/të mos lejojnë depërtimin e ujit nëse ju duhet të punoni jashtë në natyrë.

Mirëqenia juaj

- Duhet të sigurohet që të ketë banja dhe vende për t'u larë të përshtatshme për përdorim, si dhe ujë të pastër të pijshëm.
- Duhet të sigurohet që të mund të merrni ndihmë të parë të shpejtë.
- Duhet të mbajë shënim të gjithë lëndimet, sëmundjet ose rastet e rrezikshme dhe t'i raportojë ato te Qendra e Kontaktit për Incidentet e Ekzekutivit të Shëndetit dhe Sigurisë (HSE).

Gratë dhe të rinjtë

- Të marrë parasysh çdo rrezik për gratë që mund të mbeten shtatzënë, veçanërisht nëse janë shtatzënë ose duke ushqyer me gji.
- Të marrë parasysh nevojat e punëtorëve nën moshën 18 vjeç.

Çfarë duhet të bëni ju

- Duhet të siguroheni që ajo që bëni në punë të mos ju vërë ju ose të tjerët në rrezik.
- Të ndihmoni punëdhënësin tuaj të ulë rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.
- Të përdorni çdo pajisje pune siç jeni trajnuar.
- Të përdorni siç duhet çdo gjë që ju është dhënë për të ruajtur shëndetin dhe sigurinë tuaj.
- Ju duhet edhe ta njoftoni punëdhënësin tuaj (me shkrim) nëse jeni shtatzënë, duke ushqyer me gji ose nëse keni lindur fëmijë në gjashtë muajt e fundit.

Çfarë duhet bërë nëse keni shqetësime mbi shëndetin dhe sigurinë tuaj

- Flisni me punëdhënësin, menaxherin ose mbikëqyrësin tuaj.
- Flisni me përfaqësuesin tuaj të sigurisë nëse ka një të tillë.

Nëse përsëri mendoni se ju ose të tjerët jeni në rrezik, kontaktoni HSE-në. Ju mund të flisni me HSE-në në fshehtësi dhe pa dhënë emrin tuaj. Shikoni pjesën "Informacion i mëtejshëm" për të dhënat e kontaktit.

Këshilla të tjera

Sipas ligjit të MB-së, ju keni të drejta të tjera bazë si për shembull kufizimi se sa gjatë duhet të punoni, të drejtën e kohës së pushimit, pushimeve të shkurta dhe lejes vjetore të paguar. Për informacion rreth kushteve të përgjithshme të punës, kontaktoni:

- Linjën Kombëtare të Ndhmës së Shërbimit të Këshillimit, Pajtitimit dhe Arbitrazhit në numrin 08457 474747 ose me email duke përdorur faqen e tyre të internetit: www.acas.org.uk;
- Zyrën tuaj vendore të Këshillimit të Qytetarëve (Citizens Advice Bureau) (shikoni numërorin telefonik) ose përdorni faqen e tyre të internetit: www.adviceguide.org.uk;
- Lëvizjen e sindikatave. Telefononi linjën e ndihmës TUC "Të njohësh të drejtat e tua" në numrin 0870 600 4882 ose dërgojni email duke përdorur faqen e tyre të internetit: www.tuc.org.uk.

Informacion i mëtejshëm

Për informacion rreth shëndetit dhe sigurisë vizitoni faqen e punëtorëve migrantë të HSE-së në www.hse.gov.uk/migrantworkers.

Kjo fletëpalosje është lëshuar nga Ekzekutivi i Shëndetit dhe Sigurisë (HSE). Ajo përmban udhëzime mbi mënyrat e zbatimit të ligjit.

© Të drejtat e autorit Crown Ky botim mund të ribotohet lirisht, përveçse kur përdoret për qëllime reklamimi, vërtetimi ose komerciale. Botuar për herë të parë 02/13.